

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Nr. 02-50/11-07

Prishtinë, më 13 prill 2007, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Sabri Hamiti**, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 85 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 30 marsit dhe 5 prillit 2007,
3. Koha për pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë organike,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transfuzionin e gjakut dhe të produkteve të tij,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për emrin personal,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për numrin personal,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhe
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullator për Prokurim Publik për vitin 2006

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, përfaqësuesi i Listës serbe për Kosovë e ka parashtruar një mocion me shkrim, me të cilin ka kërkuar që Kuvendi mos t'i shqyrtojë pikat 6 dhe 7.

Ai e hodhi në votim mocionin e Listës serbe. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----85,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi njëzëri e refuzoi mocionin e Listës serbe për Kosovë.

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 30 marsit dhe të 5 prillit 2007

Procesverbalet e seancave plenare të 30 marsit dhe të 5 prillit 2007 u miratua pa vërejtje.

Deputeti **Numan Baliq** pati vërejtje në faqen e fundit të transkriptit të seancës plenare të 5 prillit, në konstatimin: "Kuvendi njëzëri miratoi Deklaratën për pakon e Ahtisaarit", kurse ai kishte votuar kundër.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Ibush Jonuzi** i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me funksionimin e Spitalit "Sheik Zaid" në Vushtrri.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetit Jonuzi.

Deputetja **Zylfije Hundozi** i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me nxjerrjen e Udhëzimit administrativ, me të cilin teknikëve medicinalë u zvogëlohen pagesat për kujdestari.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja **Zylfije Hundozi** i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale lidhur me mënyrën e verifikimit të shfrytëzuesve të pensioneve.

Ministri **Ibrahim Selmanj** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja **Teutë Hadri** i parashtrroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me shfrytëzimin e mjeteve për ndërtimin e objektit të Kardiokirurgjisë.

Ministri **Haki Shatri** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadri.

Deputeti **Kamber Kamberi** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë-Telekomunikacionit lidhur me asfaltimin e rrugës Botushë- Koshare.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kamberi.

Deputetja **Gjylshene Berisha** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me fushatën kundër kancerit të gjirit dhe me funksionimin e Institutit Onkologjik.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetes Berisha.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me realizimin e rekomandimeve të Komisionit për Shëndetësi.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Fatmir Rexhepi** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me trajtimin e ujërave të zeza dhe me rregullimin e shtratit të Lumit “Mirusha” në komunën e Gjilanit.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rexhepi.

Deputeti **Fatmir Rexhepi** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë-Telekomunikacionit lidhur me ndërtimin e aksit rrugor Spital-Kamnik-Montith në komunën e Gjilanit.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rexhepi.

Deputeti **Gazmend Muhaxheri** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë-Telekomunikacionit lidhur me pranimin teknik ë rrugës Ponoshec-Morinë.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Muhaxheri.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë-Telekomunikacionit lidhur me asfaltimin e rrugës për në Jezerc në komunën e Ferizajt.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtroi pyetje ministrit të Energjetikës dhe të Minierave lidhur me hapjen e vendeve të reja të punës me realizimin e projektit të “Kosova C”

Ministri **Ethem Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetes Berisha..

Katër(4) pyetjet e tjera që ua kishin parashtruar deputetët kryeministrit dhe ministrave të Qeverisë së Kosovës u shtyn për seancën tjetër, ngase ata nuk ishin të pranishëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë organike

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, **Ibrahim Selmanaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, ministri **Selmanaj** shpjegoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Selmanaj**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: **Afrim Arzuallxhiu** në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Fetah Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Xhavdet Neziarj** në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Teuta Sahatqija** në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s dhe **Ferid Agani**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim. Në diskutim morën pjesë edhe këta deputetët: **Rifat Krasniq dhe Berat Luzha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 70;
Kundër----- 0;

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për bujqësinë organike.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

Pas pauzës seanca i filloi punimet me shqyrtimin e dytë të projektligjeve.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transfuzionin e gjakut dhe të produkteve të tij

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin për transfuzionin e gjakut dhe të produkteve të tij.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7,8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----75;
Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi Ligjin për transfuzionin e gjakut dhe të produkteve të tij.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për emrin personal

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Siguri për Projektligjin për emrin personal.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7,8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32.

Gjatë shqyrtimit të amendamenteve pati vërejtje nga disa deputetë për formulime jo të sakta gjuhësisht.

Kryesuesi tha se Projektligji, para se të dërgohet për shpallje, duhet të lekturohet.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----74;

Kundër----- 0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi Ligjin për emrin personal.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për numrin personal

Kryesuesi i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Naim Maloku, kryetar i Komisionit për Siguri i arsyetoi raportin dhe rekomandimet e Komisionit.

Kryesuesi i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Siguri për Projektligjin për numrin personal.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 4, 5, 6, 7,8, 9, 10, 11 dhe 12.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----73;

Kundër----- 1.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash,miratoi Ligjin për numrin personal. Kryesuesi dhe pushim për drekë.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e Konsumatorit

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit ta arsyetonte raportin para deputetëve të Kuvendit.

Ibush Jonuzi, kryetar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion – tha se Komisioni në bazë të rregullës 53 të Rregullores së punës së Kuvendit dhe të përgjegjësive që i mbulon në fushën e tij ka hulumtuar disa muaj se si po zbatohet Ligji për mbrojtjen e konsumatorit.

Komisioni patë formuar një grup pune për të monitoruar zbatimin e këtij ligji. Grupi i punës ka mbledhur informata të nevojshme në dy faza. Në fazën parë, ka mbledhur fakte nga burimet joministore si: institucionet lokale të qeverisjes, prodhuesit vendorë, ndërmarrjet tregtare shërbyese, organizatat relevante joqeveritare dhe qytetarë. Në fazën e dytë, ka mbledhur informacione nga Ministria për Tregti dhe Industri.

Komisioni ka organizuar tetë vizita në terren dhe 3 dëgjime publike për të siguruar sa më shumë informata lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe për të shikuar se cilat janë pengesat që haset në terren për zbatimin e tij.

Grupi i punës ka përgatitur një **pyetësor**, që u është dërguar institucioneve lokale për të vlerësuar shkallën e zbatimit të ligjit: pengesat për zbatimin, niveli i bashkëpunimit me institucionin qendror dhe informimi i opinionit mbi ekzistimin e legjislacionit përkatës.

Konstatimi i gjendjes faktike është se: Ligji për mbrojtjen e konsumatorit ende nuk është kompletuar me akte nënligjore për zbatimin e tij të plotë dhe ekzistojnë zbrastëra ligjore, sidomos në fushën e penalizmit dhe të sanksioneve.

Komisioni, në bazë të hulumtimeve që i ka bërë për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe për ta mundësuar zbatimin e efektshëm të tij, Kuvendit ia paraqet këto

REKOMANDIME

1. Të kompletohet infrastruktura ligjore që del nga Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe e ligjeve të tjera nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit,
2. Të themelohet Sektori për mbrojtjen e konsumatorit,
3. Të fillohet procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të ligjeve të lartshënuara,
4. Të shtohet bashkëpunim me Shërbimin Doganor të Kosovës dhe të trajtojë çështje me interes për konsumatorin: afati i mjaftueshëm, prejardhja, cilësia, origjinaliteti, azhuriteti për ofrimin e shërbimeve të tjera,
5. Të shtohet bashkëpunimi i autoriteteve qendrore me ato lokale, me qëllim të zbatimit të infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e konsumatorit,
6. Të organizohen format e bashkëpunimit në rrafshin horizontal të inspektorëve të fushave të ndryshme në nivelin rajonal e komunal,
7. Të inspektohen procesi dhe cilësia e prodhimeve të prodhuesve vendorë, posaçërisht ato të industrisë ushqimore,
8. Të rritet numri vizitave të kontrollimeve nga inspektorët në ndërmarrjet tregtare, shërbyese dhe prodhuese,
9. Të formohen shoqatat e konsumatorëve dhe
10. Të organizohen forma të ndryshme të informimit të qytetarëve e të konsumatorëve për të drejtat e tyre.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin për raportin e Komisionit lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për raportin e Komisionit lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhanë në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së **Bajrush Xhemajli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim **Ferid Agani**, si dhe deputetët: **Sala Berisha-Shala**, **Zylfije Hundozi**, **Hydajet Hyseni** dhe **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi e hodhi në votim raportin e Komisionit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----66;

Kundër-----1;

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi i Kosovës miraton raportin dhe rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.
2. Kuvendi i Kosovës e obligon Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë që t'i zbatojë në tërësi rekomandimet e Komisionit të paraqitura në raportin e tij për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullator për Prokurim Publik për vitin 2006

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit Rregullator për Prokurim Publik ta arsyetonte raportin para deputetëve të Kuvendit.

Ilaz Duli, kryesues i Komisionit Rregullator për Prokurim Publik - tha: Në këtë raport të punës janë përfshirë të gjitha aktivitetet e punës së Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik që janë ndërmarrë nga 1 janari i vitit 2006 deri më 31 dhjetor të vitit 2006. Unë do të përpiqem në pika shumë të shkurtra t'i paraqes disa nga aktivitetet më të rëndësishme të KRPP-së të cilat janë të përfshira në këtë raport.

Komisioni gjatë auditimeve dhe shqyrtimeve të ankesave në të gjitha rastet kur ka gjetur fakte dhe shkeljen e ligjit ka marrë masat që parashihen me ligj dhe ka marrë disa masa të cilat ka kërkuar që menaxherët e prokurimit për moszbatim të Ligjit të largohen nga Departamenti i Prokurimit, natyrisht t'u anulohet certifikata.

Masa të ngjashme janë marrë edhe ndaj operatorëve joseriozë, që marrin pjesë në procedurat e prokurimit, si me futjen në listën e zezë për një afat të caktuar me konfiskimin e garancionit bankar për aneks, si edhe me paraqitjen për kallëzim penal.

Në Departamentin e Shqyrtimit të Ankesave numri i tyre ka shënuar një rritje, krahasuar me vitin paraprak, që është një besim në institucionet që merren me prokurimin publik në Kosovë dhe me shqyrtimin e ankesave. Nga 423 ankesa, mesatarja e shqyrtimit të tyre ka qenë 16 ditë dhe në gjitha vendimet e Komisionit pala e pakënaqur ka pasur të drejtë të ankohet dhe vetëm një rast është paraqitur në Gjykatën Supreme, që është duke u shqyrtuar.

Në Departamentin e Rregullave është hartuar legjislacionit dytësor. Ka nxjerrë katër formularë standardë dhe tetë manuale të prokurimit, që i ka publikuar në faqen zyrtare të internetit në Kosovë dhe me këtë është rumbullakuar legjislacioni dytësorë, që lehtëson zbatimin e Ligjit për prokurimin publik.

Në Departamentin e Auditimeve janë kryer pesë auditime, 24 inspektime dhe 12 raste ka bërë interpretimi në Ligjit të Prokurimit Publik. Është një konstatim i përgjithshëm se në vitin 2006 është shënuar një rritje e zbatueshmërisë së Ligjit në krahasim me raportin e vitit të mëparshëm.

Në Departamentin e Trajnimeve janë trajnuar 360 zyrtarë të prokurimit, duke i përfshirë këtu edhe pjesëtarët nga komunitetet e tjera. Këto trajnime, në bazë të ligjit, janë mbajtur brenda 10 ditësh, mirëpo duke marrë parasysh se grupet kanë qenë mjaft të mëdha, është dashur të bëhej ndarja në 7 grupe dhe brenda vitit ky departament ka mbajtur 70 ditë trajnime në lëmin e prokurimit publik.

Pastaj **kryesuesi** e hapi diskutimin për shqyrtimin e raportit të KRRPP-së për vitin 2006.

Opinione, vërejte dhe sugjerime për raportin e KRRPP-së për vitin 2006 dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Behxhet Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazllom Kumnova**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Nazim Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Ferid Agani**, si dhe deputetët: **Bajrush Xhemajli**, **Safete Hdërgjonaj** dhe **Gani Koci**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, kryesuesi i KRRPP-së, **Ilaz Duli** iu përgjigj vërejtjeve të deputetëve.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e raportit e punës të KRRPP-së për vitin 2006. Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për-----44;
Kundër-----18;
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi raportin e punës të Komisionit Rregullator për Prokurim Publik për vitin 2006.

Kryesuesi seancën e deklaroi të mbyllur në orën 16:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale